

Banka Për Biznes, Zyra Qendrore në Prishtinë shpall konkurs për pozitën:

KONKURS

Menaxher i Sektorit për Monitorim të Kredive (m/f)

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare (*Preferohet Master në Ekonomi, Administrim Biznesi, Banka dhe Financa apo Menaxhment*);
- Përvojë e mëparshme jo më pak se 3 vite në Banka (*Preferohet në fusha të menaxhimit të risku kreditor*);
- Aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe prezantimit;
- Aftësi të shkëlqyeshme analitike dhe të metodave hulumtuese;
- Shkathtësi në caktimin e objektivave dhe planifikimin e punës;
- I/e aftë të punojë në ekip dhe në mënyrë të pavarur;
- Nivel i avancuar i Gjuhës Angleze dhe përdorimit të Microsoft Office-it Office (posaçërisht në Excel).

Përgjegjësitë Kryesore:

- Menaxhon procesin e monitorimit të ekspozimeve kreditore;
- Përgjegjës për identifikimin, analizimin dhe raportimin e faktorëve të rrezikut kreditor përmes procesit të monitorimit të kredive;
- Analizon dhe teston mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit për të ruajtur cilësinë e profilit të rrezikut të segmenteve portfolios kreditore;
- Menaxhon modulën e monitorimit në aplikacionin e kreditimit;
- Përfshihet aktivisht në vlerësimin, zhvillimin dhe automatizimin e proceseve dhe sistemeve që lidhen me menaxhimin e riskut kreditor;
- Analizon sektorët ekonomik dhe përpilon raporte për nevoja të menaxhmentit për të mbështetur vendimmarrjen në procesin e kredi dhënies dhe strategjisë së biznesit.

Procedura e aplikimit:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi plotësoni formularin për aplikim duke bashkëngjitur dhe CV-në tuaj, në këtë link: <https://www.bpbbank.com/forma-e-aplikimit-per-punesim/>

Pas seleksionimit të dokumentacionit do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë. Afati i aplikimit është deri me datë: **18 Shtator 2019.**